



REPUBLIKA E KOSOVES-REPUBLIKA KOSOVA REPUBLIC OF KOSOVO
KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
NEZAVISNI NADZORNI ODBOR CIVILNE SLUŽBE KOSOVA
INDEPENDENT OVERSIGHT BOARD CIVIL SERVICE OF KOSOVO

Pranuar / Dorezuar Prijmjenoi/Predato Received/Delivery	16.04	2021	1	viti god year
Organ /Njesia Organ /Jedinitca Org /Unit	Nr Prot Br Prot Prot No	Shtojca Prilog Appendix	Sasia Kolicina Quantity	
SKMSTHX	1838/2021		1/3	



Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
NEZAVISNI NADZORNI ODBOR CIVILNE SLUŽBE KOSOVA
INDEPENDENT OVERSIGHT BOARD FOR THE CIVIL SERVICE OF KOSOVO

A.nr.135/2021

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës-Kolegji për shqyrtimin e ankesave në përbërje nga: Eshref Shabani -kryetar, Malsore Gashi Bajraktari dhe Arben Mehmeti -anëtarë me Flakron Gashi-Zyrtar i Lartë për Bashkëpunim Profesional në cilësinë e procesmbajtësit, ka shqyrtuar ankesën me numër Anr.135/2021 të datës 12.03.2021 të parashtruar nga ankuesi me adresë banimi: Rruga “Idriz Gjilani”, Dardani Nr. 507/ Hyrja 13 Komuna e Prishtinës, kundër organit të punësimit Ministrisë së Tregtisë dhe Industrisë, në çështjen juridike “kompensim material”, duke vepruar në pajtim me nenin 6 paragrafin 1 nën paragrafin 1.1 dhe nenin 18 paragrafin 1 nën paragrafin 1.5 të Ligjit Nr. 06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës dhe Rregulloren Nr. 02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosies së Ankesave në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, në seancën për këshillim dhe votim të mbajtur më datën 16.04.2021, mori këtë:

V E N D I M

Përfundon Procedimi Administrativ i iniciuar me ankesën me numër A.nr.135 të datës 12.03.2021 të parashtruar nga ankuesi

A r s y e t i m

Ankuesi sipas Akt Emërimit të datës 08.10.2014 i punësuar në Ministrinë e Tregtisë dhe Industrisë në pozitën “Udhëheqës i Divizionit për Teknologji Informative dhe Shërbime Logjistike në Departamentin për Financa dhe Shërbime të Përgjithshme”, i pakënaqur me vendimin me shifër Ref.02/15 të datës 21.01.2021 të Zv. Sekretares së Përgjithshme të Ministrisë së Tregtisë dhe Industrisë, me datë 12.03.2021 ka parashtruar ankesë me numër protokollit 1113/2019 në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës.

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës më datë 17.03.2021 ka dërguar kërkesën për përgjigje në ankesën e ankuesit tek Ministria e Tregtisë dhe Industrisë. Më datë 22.03.2021 Ministria e Tregtisë dhe Industrisë ka dërguar përgjigjen në ankesë me dosjen e bashkangjitur të lëndës.

Kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave ka administruar këto prova: Ankesën e datës 12.03.2021 e parashtruar nga ankuesi me numër protokollit 1113/2021 në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin

Civil të Kosovës; E-mailin e datës 23.03.2021 me numër protokollit 1331/2021 për plotësimin dhe precizimin e ankesës së datës 12.03.2021; Kërkesën me numër protokollit: 1715/2021 të datës 12.04.2021 për tërheqje të ankesës së datës 12.03.2021; Kërkesën për përgjigje në ankesë të datës 17.03.2021; E-mailin e datës 30.11.2020 dërguar nga ankuesi për _____ më korrespondencën e bashkangjitur prej 6 (gjashtë) faqesh; Vendimin me shifër Ref.02/15 të datës 21.01.2021 të Zv. Sekretares së Përgjithshme të Ministrisë së Tregtisë dhe Industrisë; Emailin e datës 01.02.2021 dërguar nga ankuesi për _____ Kërkesën për shtesa të datës 01.02.2021; E-mailin e datës 03.02.2021 dërguar nga _____ për ankuesin me korrespondencën e bashkangjitur prej 2 (dy) faqesh; Diplomën e ankuesit të datës 14.02.2010 më numër 536/10; Ndryshim Plotësimin e akt emërimit të ankuesit të datës 08.10.2014 dhe përshkrimin e detyrave të punës; letër referencën e datës 21.09.2020; Certifikatën e datës 13.06.2019; Certifikatën të muajit qershor 2016; Certifikatën të muajit shkurt 2016; Certifikatën e datës 22.09.2020; Kërkesën për shtesa në pagë dërguar Drejtorit të DASHC/MPBAP-së të datës 11.02.2021 dhe numër prot:874; Vendimin e Kryeministrit të Republikës së Kosovës të datës 08.10.2008 me numër Nr.02/39 me Listën dhe titujt e punonjësve që do të jen përfitues të masave stimuluese; Raportin e Auditimit për Ministrinë e Tregtisë dhe Industrisë për vitin 2018; Raportin e Auditimit për pasqyrat financiare të Ministrisë së Tregtisë dhe Industrisë për vitin 2019; Përgjigjen në kërkesë të datës 22.03.2021 me numër protokollit:1315/2021; Kërkesën për shtesa të datës 16.06.2014; E-mailin e datës 30.11.2015 dërguar nga ankuesi për Imer Lladrovci më korrespondencën e bashkangjitur prej 3 (tre) faqesh; Shkresën e Kryeministrit të Republikës së Kosovës të datës 09.01.2015 me numër protokollit:28; Raportin e Auditimit për Ministrinë e Tregtisë dhe Industrisë për vitin 2019 në përmbajtje prej 2 (dy) faqesh; Kërkesën për shtesa në pagë dërguar Drejtorit të DASHC/MPBAP-së të datës 16.10.2020 dhe numër prot:7655; E-mailin e datës 02.12.2020 dërguar nga _____ për _____ me korrespondencën e bashkangjitur prej 3 (tre) faqesh; Kërkesën për përgjigje në ankesë të datës 04.12.2020; Ankesën e ankuesit të parashtruar në Këshill me datë 03.012.2021; Përgjigjen në kërkesë të datës 10.12.2020 me numër prot:9199.

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave, pasi ka shqyrtuar të gjitha shkresat e bashkangjitura të lëndës dhe kërkesën e ankuesit të datës 12.04.2021, ka konstatuar se objekti për të cilin ka filluar procedimi administrativ me ankesën e ankuesit _____ është bërë i pamundur, *sepse*:

Kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave, ka konstatuar se ankuesi më datë 12.03.2021 ka parashtruar ankesë me numër protokollit 1113/2021 në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, ndërsa më datë 12.04.2021 ka parashtruar kërkesë me numër protokollit 1715/2021 për tërheqje të ankesës me numër të protokollit 1113/2021 të datës 12.03.2021.

Kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave, pas tërheqjes së ankesës nga ana e ankuesit konstaton se kërkesa për tërheqje të ankesës është e drejtë e ankuesit e përcaktuar me dispozitat nenit 103 paragrafit 1 të Ligjit Nr. 05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative, i cili përcakton se: *"Një procedurë administrative e nisur sipas kërkesës, përfundon nëse pala që e ka bërë kërkesën e tërheq atë"*, andaj bazuar në këtë veprim administrativ të ankuesit, konstatohet se është përmbushur kushti ligjor për të vendosur për përfundim të procedimit administrativ të iniciuar sipas ankesës me numër protokollit 1113/2021 e parashtruar nga ankuesi

Andaj, pas analizimit dhe vlerësimit të të gjitha shkresave të lëndës si dhe duke u bazuar në nenin 6 paragrafin 1 nën paragrafin 1.1 si dhe nenin 18 paragrafi 1 nën paragrafi 1.5 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, Kolegji vendosi si në dispozitiv të këtij Vendimi.

Këshillë juridike: Kundër vendimit të Këshillit, pala e pakënaqur e cila pretendon se vendimi i Këshillit nuk është i ligjshëm mund të iniciojë konflikt administrativ në Gjykatën Themelore në Prishtinë-Departamenti për Çështje Administrative, brenda afatit prej tridhjetë (30) ditësh, nga dita në të cilën i është dorëzuar vendimi. Inicimi i konfliktit administrativ nuk e ndalon ekzekutimin e këtij vendimi.

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës
Lënda me numër A.nr.135/2021

Elakron Gashi



Zyrtar i Lartë për Bashkëpunim Profesional



Eshref Shabani

Kryetar i Kolegjit

Vendimi i dorëzohet:

- *Ankuesit*
- *Sekretarit të Përgjithshëm të Ministrisë së Tregtisë dhe Industrisë;*
- *Udhëheqësit të Burimeve Njerëzore në Ministrinë e Tregtisë dhe Industrisë dhe*
- *Arkivit të KPMSHCK-së*

